VENDIM
Nr. 82, datë 28.1.2015

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "RIKONSTRUKSION DHE ZGJERIM I RRUGËS "DON GJON BUZUKU", KORÇË"

(Ndryshuar me VKM nr. 831, datë 7.10.2015; nr. 498, datë 29.8.2018)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Rikonstruksion dhe zgjerim i rrugës "Don Gjon Buzuku", Korçë".

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë Korçë.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë truall, banesë dhe ndërtesë, me një vlerë të përgjithshme prej *77 567 636 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh.*

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej *77 567 636 (shtatëdhjetë e shtatë milionë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekësh* të përballohet nga subjekti kërkues, Bashkia Korçë, kurse shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga buxheti i vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban dhe Turizmit.

5. Shpronësimi të fillojë në datën 5.2.2015.

6. Pronarët e përmendur në listën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin e plotë të pronësisë pranë Bashkisë Korçë.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Korçë, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

8. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën treguese të regjistrimit dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

9. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Korçë dhe Bashkia Korçë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

TABELA E DETAJUAR E VLERËS SË SHPRONËSIMIT PËR PROJEKTIN "RIKONSTRUKSION DHE ZGJERIM I RRUGËS "DON GJON BUZUKU" KORÇË

Nr.	Nr. pasurie	Emër, atësi, mbiemër	Lloji i pasurisë	Sip. truall total sipas ZVRPP m^2	Vlera truall lekë/m^2	Nr. kate	Sip. banesë totale nd. (m^2)	Vlera banesa lekë/m^2	Sip. njësi shërbim (m^2)	SIP. trualli e pjesshme (m^2)	Vlera e truallit total (lekë)	Vlera e banesës (lekë)	Vlera e njësisë shërbim (lekë)
1	5/347	Rita Ali Koça, Spiro Hekuran Koça	T+Nd	79.6	7,535	2.5	137	45,230			_	6,196,510	
2	**5/598**	**Natasha Alit Strati(Zesllati)**	**T+Nd**	**99**	**7,535**	**2**	**29.6**	**45,230**			_	**1,338,808**	
3	5/876	Agim Beshir Bardhi + bpr	T+Nd	70.5	7,535	1	38.5	45,230			_	1,741,355	
4	5/824	Bajram Faslli Tako	Nd		7,535	1	45	45,230			_	2,035,350	
5	5/130	Arben Feta	T+Nd	131	7,535	2	171	45,230			_	7,734,330	
6	5/558	Jorgo Stefa	T+Nd	114	7,535	1	78.08	45,230			_	3,531,558	
7	5/859	Agim Hajdar Tefik	T+Nd	114	7,535	3	152.22	45,230			_	6,884,911	
8	**5/177**	**Hydbi Sabri Kape**	**T+Nd**	**135.3**	**7,535**	**2**	**45.6**	**45,230**			_	**2,062,488**	
9	5/175	Gurije Rakollari +bpr	T+Nd	134.4	7,535	1	31.9	45,230			_	1,442,837	
10	5/426	Petrit Musa Xhelollari	T+Nd	137.8	7,535	3	247	45,230	74		1,038,323	11,171,810	2,154,342
11	**5/440**	**Zamir Islam Topi**	**T+nd**	**22.8**	**7,535**			_	**22.8**		**171,798**	**0**	
12	5/458	Robert Çarçani	T+Nd	90	7,535	1		_	70		678,150	0	2,145,487
13	**5/352**	**Serdil Manka ,Musa Manka**	**T+Nd**	**170.7**	**7,535**	**2**	**142.4**	**45,230**		**49.2**	_	**6,440,752**	
14	**5/131**	**Ari Fuat Maliq**	**T+Nd**	**135.2**	**7,535**	**1**	**7**	**45,230**		**58**	**437,030**	**316,610**	
15	**5/348**	**Zini Besim Berberi**	**T**	**441.4**	**7,535**		_			**90.7**	**683,425**		
16	**5/353**	**Ali Afiz Goçllari**	**T**	**184.2**	**7,535**		_			**27.4**	**206,459**		
17	**5/556**	**Gjylizar Koçibelli**	**T**	**120.8**	**7,535**		_			**5.2**	**39,182**		
18	5/829	Kristal Shyti	T	66.2	7,535		_				498,817		
19	5/537	Salie Shishmani	T	151.2	7,535		_				1,139,292		
20	5/538	Hektor Frashëri	T	66.6	7,535		_				501,831		
21	5/441	Altin Ismail Topi+bpr	T	118.1	7,535		_				889,884		
22	5/452	Edmond Haxhi Zake	T	202	7,535		_				1,522,070		
23	5/439	Mukadez Riza Topi	T	177	7,535		_				1,333,695		
24	5/472	Feride Teki Moskopoliti	T	77.3	7,535		_				582,456		
25	5/475	Isa Tefik Gegollari	T	78	7,535		_				587,730		
26	5/448	Ali Qeraxhi + bpr	T	750	7,535		_				5,651,250		
27	5/900	Riza Zeni Lika + bpr	T	69.5	7,535		_				523,683		
28	5/964	Vladimir Agolli + bpr	T	77	7,535		_				580,195		
		TOTALI											

(Shtuar tabela me VKM nr. 498, datë 29.8.2018)

Lista e emërore e personave dhe pronave që i shtohen tabelës bashkëlidhur VKM-së nr. 82, datë 28.1.2015 "Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga rikonstruksioni dhe zgjerimi i rrugës 'Don Gjon Buzuku',
Korçë, të ndryshuar"

Tabela 1.1

Nr.	Emri Mbiemri	Z.K.	Nr. i pasurisë	Sip. trualli/m^2	Çmimi i truallit/lekë/m^2	Vlera e përgjithshme/lekë	Dokumenti i pronësisë
1	Bajram Tako	8563	5/824	120	7535	904 200	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
2	Besharet Sadikaj	8563	5/638	12.5	7535	94 188	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
3	Diana Gora	8563	5/638	4.17	7535	31 396	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
4	Fatime Gora	8563	5/638	4.17	7535	31 396	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
5	Ferdinant Gora	8563	5/638	12.5	7535	94 188	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
6	Genci Gora	8563	5/638	4.17	7535	31 396	Konfirmim nga ZVRPPP-ja
	TOTALI			**157.5**		**1 186 763**	